



Pranuar / Dorezuar Priljefto/Prodato Received/Delivery	27 - 06	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHANSHICK	4943/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.811/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.811/2023 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.811/2023 e datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankues
- II. Anullohet Vendimi me Nr.14-116/05-86356/23 i datës 28.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës në pozitën Zyrtar i për Leje Ndërtimore sipas Akt Emërimit 01 nr. 112-1068 të datës 01.02.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e punës, duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e largimit nga shërbimi civil deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës që ankuesit t'i heq nga dosja personale masën disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit 01 nr.112-1068 të datës 01.02.2017 në pozitën *Zyrtar për leje Ndërtimore*, më datë 20.03.2023 Udhëheqësja e Sektorit të Urbanizmit si mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankuesit, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor me arsyetimin se *"...më datë 03.11.2022 i është shqiptuar vërejtje me shkrim si masë për shkelje disiplinore për mos vijueshmëri në punë për 5 (pesë) ditë radhazi e më shumë, dhe si rrjedhojë e mungesës në punë automatikisht edhe për shkeljen tjetër, mos përmbushje e detyrave...Duke vazhduar me mungesa në punë, të njëjtit më datën 06.01.2023 i është shqiptuar vërejtja e dytë për shkeljet e njëjta, dhe duke e njoftuar se do të paraqitet raport për shkeljet disiplinore të supozuara...edhe më tutje saktësisht me datë 20.03.2023 zyrtari mungon në vendin e punës pa njoftim paraprak..."*.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës më datë 28.04.2023 ka nxjerr Vendimi me Nr.14-116/05-86356/23 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *"largim nga shërbimit civil"*.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, të cilën vendim tw konfirmuar sipas fletë kthesës e ka pranuar më datë 05.05.2023, ndwrsa më datë 05.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4585/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli më datë 21.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4585/2023 të datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Rekomandim mjekësor i datës 18.03.2023 nga Raport i ndërprerjes së përkohshme në punë për periudhën 18-24.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 21.06.2023; Akt Emërimit 01 nr.112-1068 të datës 01.02.2017; Fletë kthimin e datës 05.05.2023; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar i datës 20.03.2023 protokolluar më datë 21.03.2023; Fletëthirrje për seancë të Komisionit Disiplinor për datën 31.03.2023 pa datë; Raportin e vijueshmërisë në punë për ankuesin për periudhën janar-

prill 2023; Vërejtën e datës 06.01.2023 dhe e datës 03.11.2023 përmes emailit nga N.K për ankuesin; Emailin e datës 31.10.2022 nga ankuesi për E.L; Emailin e datës 03.04.2023 nga D.Gj për A.K; Emailin e datës 24.03.2023 nga A.K për D.Gj; Emailin e datës 22.03.2023 nga ankuesi për N.K; Emailin e datës 22.03.2023 nga N.K për ankuesin; Emailin e datës 22.03.2023 nga A.K për N.K; Emailin e datës 20.03.2023 nga D.Gj për P.M; Emailin e datës 17.03.2023 nga P.M për D.Gj; Emailin e datës 16.03.2023 nga N.K për P.M; Emailin e datës 16.03.2023 nga D.Gj për A.S dhe N.K; Procesverbalin e datës 31.03.2023 të Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton në tersi Vendimin me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”*, do të bëjë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë.

Lidhur me pretendimet ankimore lidhur me kundërshtimin e Vendimit me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se procedura disiplinore ndaj ankuesit është inicuar më datë 20.03.2023 nga Udhëheqësja e Sektorit të Urbanizmit, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës në Vendimin me Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 thekson se raporti i inicimit të procedurës disiplinore është pranuar nga Komisioni Disiplinor më datë 22.03.2023, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës pas mbajtjes së seancës disiplinore të datës 31.03.2023, me datë 28.04.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr.14-116/05-86356/23 i kundërshtuar me ankesë. Andaj, Kolegji duke ju referuar nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë me të cilin është përcaktuar se: *“Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore”*, si dhe duke marrë parasysh faktin se në shkresat e lëndës me asnjë provë nuk dëshmohet se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ka nxjerr vendim për shtyrje të afatit lidhur me përfundimin e procedurës disiplinore ashtu siç përcaktohet me nenin 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerr jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, dhe si tillë një akt administrativ i nxjerr me shkelje procedurale konsiderohet akt i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke qenë së vendimi i kundërshtuar me ankesë është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të cilat e bëjnë të paligjshëm një akt administrativ, Kolegji i Këshillit nuk u lëshua në konstatimin e pretendimeve materiale, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për aprovimin e ankesës dhe anulimin e Vendimit Nr.14-116/05-86356/23 të datës 28.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, duke obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthej në pozitën e punës *Zyrtar për Leje Ndërtimore* sipas Akt Emërimit 01 nr. 112-1068 të datës 01.02.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e largimit nga shërbimi civil deri në zbatimin e këtij vendimi, po ashtu duke e obliguar Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës që ankuesit t'i heq nga dosja personale masën disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.811/2023, datë 27/06/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarin të Komunës së Prishtinës;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.